



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.312/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj dhe anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.312/2025 e datës 02.02.2025.
- II. Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 3,000.00 (tremijë) euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 02.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se më 02 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore ka vërejtur përdorimin e objekteve publike në kundërshtim me ligjin, nga kandidatja për deputet znj. Linda Bekteshi, në Palestrën e Sporteve "Adem Jashari" në Obiliq, me datë 02.02.2025 nga radhët e LDK-së me çka konsiderojmë se ka renë ndesh me nenin 36, par 3 i LZP-së.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur CD nga palestra "Adem Jashari".

Më datë 03.02.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 03.02.2025 në ora 19:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 03.02.2025, Subjekti Politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), duke theksuar se Kandidatja në fjalë ka pasur pëlqimin e Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Obiliq, i cili i është dhënë subjektit politik LDK dhe kandidatëve për deputet që ta shfrytëzojnë me datën 02.02.2025 për mbajtjen tubimit qendror si dhe shfrytëzimit të hapësirave të jashtme dhe të brendshme.

Si provë në Përgjigje në ankesë Subjekti Politik LDK, ka bashkangjitur Formularin e njoftimit për mbajtjen e tubimit publik.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik LDK, ka përdorur objektet publike, konkretisht Palestrën Sportive “Adem Jashari” në Obiliq ku kandidatja për deputete znj.Linda Bekteshi e ka shfrytëzuar hapësirën një ditë para datës për të cilën kanë pasur leje pra me këtë veprim subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LKP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LKP-së parasheh: *"1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.*

Paneli ka vlerësuar sqarimin e bashkangjitur nga subjekti politik LDK, përkatesisht formularin e njoftimit për mbajtjen e tubimit publik në të cilin parashihet koha e fillimit të tubimit të planifikuar ora 18:00 dhe koha e përfundimit 20:00 me datë 02.02.2025 në Palestrën Sportive “Adem Jashari” në Obiliq ndërsa kandidatja për deputete znj.Linda Bekteshi e ka shfrytëzuar hapësirën një ditë para datës për të cilën kanë pasur leje.

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LKP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se "subjekti politik që është përfutues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20, 000.00)euro.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin

zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.312/2025 më datën 04.02.2025

Kryesuese e Panelit
Skender Çoçaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi. 4 të LZP-së.